

VENDIM
Nr.276, datë 9.5.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË
FURNIZIMIT ME UJË NGA REZERVUARI I MANSKURISË, GOLEM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit të furnizimit me ujë nga rezervuari i Manskurisë, Golem.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, z.Nazmi Sinarezi, të kompensohet në vlerë të plotë, për sipërfaqen 650 m², tokë bujqësore, me çmim 800 lekë/ m², me vlerë të përgjithshme 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 133 500 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohet nga Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë.
 6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit maj 2007.
 7. Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë, të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të përcaktuar në pikën 6.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARIT QË DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I REALIZIMIT TË
PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË NGA REZERVUARI I MANSKURISË, GOLEM**

Nr.	Emri	Zk	Nr.pas	Sip tokë bujqësore	Çmimi l/m ²	Vlera lekë	Vlera totale lekë
1.	Nazmi Riza Sinarez	2291	16/7	650	800	520 000	
	Shuma						520 000

Totali 520 000 (pesëqind e njëzet mijë) lekë.